



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITETI "HAXHI ZEKA" PEJE
REKTORATI			
Nr. / Br. / No.	<u>1193</u>	Nr. i faq/ Br. str / No. pg	<u>6</u>
Data / Datum / Date:	<u>19.05.2023</u>	Pejë / Poë	

RREGULLORE MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS PËR PËRKRAHJEN E BIZNESEVE

Pejë, Maj 2023

Në bazë të nenit 23 dhe nenit 82 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit nr.04-V-622 të UHZ, Këshilli Drejtues i Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në mbledhjen e mbajtur me dt. 14.05.2023, miratoi këtë:

RREGULLORE MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS PËR PÛRKRAHJEN E BIZNESEVE

Qëllimi

Neni 1

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë organizimin dhe funksionimin e Qendrës për Përkrahje të Bizneseve (më tutje e quajtur QPB). QPB shërben si pikë referimi e rëndësishme për të udhëhequr një sërë aktiviteteve dhe veprimesh të ndërmarrë nga QPB në shërbim të komunitetit të biznesit, organizatave qeveritare dhe jo qeveritare, si dhe iniciativave individuale dhe qytetare e me gjerë.

Fushëveprimi

Neni 2

1. QPB fokusohet në aktivitete konkrete për të motivuar komunitetin e biznesit, mësimdhënësit, studentët në fushën e ndërmarrësisë. Kjo do realizohet me partnerë dhe me industrinë nëpërmjet shërbimeve të QPB. Po ashtu, kjo qendër do mbajë lidhje të afërta me bizneset partnere për t'ju përgjigjur nevojave të tyre.
2. QPB është urë lidhëse mes universitetit dhe tregut të punës. Qasja e qendrës do jetë ofrimi i përkrahjes në të gjitha mënyrat në drejtim të ndërmarrësisë dhe inovacionit, për edukim dhe zhvillim të shkathtësive për adaptim ndaj ndryshimeve të kohës dhe trendeve bashkëkohore. QPB do të jetë në shërbim të bizneseve në rajonin e Pejës dhe më gjerë.

Përkufizimet

Neni 3

Shkurtesat e përdorura në këtë rregullore e kanë kuptimin si në vijim:

UHZ – Universiteti Haxhi Zeka

QPB – Qendra për Përkrahje të Bizneseve

KKK – Korniza Kombëtare e Kualifikimeve

Aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë e QPB

Neni 4

Aktivitetet, detyrat dhe përgjegjësitë e qendrës për përkrahje të bizneseve janë:

1. Përgatite dhe zbaton programe profesionale deri në nivelin e pestë të KKK;
2. Identifikon programe të reja profesionale sipas nivelit të pestë të KKK;
3. Zgjeron komunikimin me komunitetin rajonal të biznesit dhe rrit angazhimin universitet-biznes;


4. Inkurajon veprime ndërmarrëse midis komunitetit të studentëve, si dhe mbështetja e aktiviteteve ndërmarrëse në rajon dhe me gjerë;
5. Ofron asistencën profesionale sipas nevojave të komunitetit të biznesit nga fusha e biznesit, turizmit, tregtisë, drejtësisë, agro-ekonomisë, teknologjisë së informacionit, arteve, etj;
6. Organizon kurse, seminareve dhe punëtorive të tipit “Mësimi gjatë gjithë jetës” për të gjithë të interesuarit;
7. Promovon mundësi biznesi për studentë dhe njoftojë ata me sfidat e të bërit biznes;
8. Ofron hapësira të ndryshme infrastrukturore për nevojat e inkubatorëve të bizneseve;
9. Ofron asistencë për “One-Stop Shop”-e përmes teknikave dhe praktikave të ndryshme, si: hartimi i planeve të biznesit për një biznes të suksesshëm, përgatitja e dokumenteve për aplikim në projekte, plotësimi i formularëve, këshilla profesionale, etj!
10. Trajnon dhe certifikon personelin e bizneseve për shkathhtësi të buta;
11. Gjen partnerë të volitshëm afaristë vendor dhe të huaj dhe përafrimi i tyre;
12. Identifikon partnerë për bashkëpunim me partnerë jashtë vendit;
13. Bashkëpunon dhe zhvillon shërbime ose produkte të reja, ben testimin e aplikacioneve të reja, ofron përdorimin e pajisjeve laboratorike të UHZ për nevoja të biznesit, etj;
14. Bën këshillim teknik për bashkëpunimet tregtare (nën-kontraktimi);
15. Ofron këshilla për mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
16. Jep këshilla dhe informacion mbi mundësitë e financimit për inovacione;
17. Ofron këshillime të tjera në fushat me interes për bizneset.

Organizimi dhe struktura

Neni 5

Organet udhëheqëse të QPB janë:

1. Këshilli;
2. Drejtori i QPB.



Skema organizative e QP

Këshilli

Neni 6

1. Këshilli është organi keshilldhenes i QPB;
2. Perberja e Këshillit miratohet nga Senati sipas propozimit të rektorit të UHZ, për një mandat 4 vjeçar;
3. Këshilli përbëhet prej pesë (5) anëtarëve (nga një mësimdhënës për secilën njësi akademike), tre (3) anëtarë nga bizneset (industria), nga të cilët së paku një (1) alumni;
4. Keshilli miraton planin e punes se QPB;
5. Keshilli formon komisione profesionale nga fusha te ndryshme sipas njesive akademike;
6. Anëtarët e Këshillit demonstrojnë angazhimin e tyre për forcimin e lidhjes së UHZ me komuniteti e gjerë të biznesit;
7. Anëtarësia në Këshill përfundon në këto raste:
 - 7.1. Kur një anëtar jep dorëheqje;
 - 7.2. Kur një anëtar ka vepruar në kundërshtim me parimet e punës;
 - 7.3. Kur një anëtar nuk përmbush përgjegjësitë e tij / saj, si:
 - 7.3.1. pjesëmarrjen në së paku 75% të takimeve të përgjithshme
 - 7.3.2. pjesëmarrjen në aktivitete të tjera organizative;
 - 7.3.3. përfaqësimin e misionit, qëllimit dhe zhvillimin e aktivitetit të tij / saj në përputhje me planin strategjik të UHZ;
 - 7.4. Për arsye shëndetësore;
 - 7.5. Në rast të dënimit për vepër penale; dhe
 - 7.6. Ndërprerjes së angazhimit si mësimdhënës në UHZ.

Drejtori

Neni 7

1. Drejtori duhet të jetë anëtar i QPB dhe emërohet nga Rektorit për një periudhë 4 vjeçare, nga rradhet e profesoreve te UHZ-se;
2. Drejtori eshte pergjegjjes per ,bikqyrjen e teresishme te QPB duke perfshire buxhetin, personelion dhe funksionet;
3. Përgjegjësitë dhe detyrat specifike të drejtorit përcaktohen në vendimin e emërimit;
4. Drejtori i QPB i raporton rektorit;
5. Për punët specifike te Qendrës, Drejtori keshillohet me Këshillin e QPB;

Përfundimi para kohe i mandati të Drejtorit

Neni 8

1. Mandati i drejtorit mund të përfundojë para kohe në rast të:
 - 1.1. dorëheqjes;
 - 1.2. shkarkimit nga detyra;
 - 1.3. arsye shëndetësore;
 - 1.4. dënimit për vepër penale;
 - 1.5. pensionimit;
 - 1.6. vdekjes.

2. Shkarkimi nga detyra i drejtorit mund të bëhet në rastet kur vepron në kundërshtim me Statutin e UHZ, Kodin e Etikës dhe aktet tjera të UHZ.
3. Vendimin për shkarkim e merr rektori pas të jetë konsultuar me Këshillin e Qendrës.

Takimet e Këshillit

Neni 9

1. Anëtarët e këshillit udhëheqës organizojnë së paku 4 takime në vit.
2. Mbledhjet organizohen më shumë se katër herë në vit nëse këtë e kërkon Drejtori i QPB-së ose së paku një e treta e anëtarëve të këshillit.
3. Kuorumi konsiderohet valid nëse në takim janë të pranishëm të paktën 50% e anëtarëve të këshillit të QPB-së.
4. Anëtarët konsiderohen si të pranishëm në qoftë se ata komunikojnë nëpërmjet aplikacioneve të video-konferencës.

Kryesimi i Këshillit

Neni 10

1. Këshilli kryesohet nga drejtori i QPB-së.
2. Drejtori mund të emëron një nga anëtarët e këshillit për të kryesuar për kohësisht takimet.
3. Vendimet e marra në takimin e Këshillit të QPB nënshkruhen nga Drejtori i Qendrës.

Vendimmarrja

Neni 11

1. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
2. Çdo anëtar ka një votë.
3. Në rast se numri i votave në favor dhe kundër një propozimi është i barabartë, atëherë vota e kryesuesit është vendimtare.
4. Anëtarët e Këshillit tërhiqen nga votimi për çdo çështje në të cilën ata kanë konflikt interesi.

Burimet e financimit

Neni 12

Qendra zhvillon veprimtarinë e saj me mjete financiare siguruar nga:

1. Mjetet buxhetore të UHZ, të ndara enkas për funksionimin e saj.
2. Fondet e BE-së.
3. Mjetet që realizon QPB përmes shërbimeve të veta.
4. Donacione të tjera alternative ligjore.
5. Subvencione / grante të jashtme për mbështetjen e veprimtarisë së QPB.
6. Burime të tjera ligjore.

Neni 13

1. UHZ çdo vit kalendarik përcakton buxhetin e QPB për realizimin e veprimtarisë së saj.
2. Të gjitha të hyrat dhe shpenzimet nga puna dhe veprimtaria e saj transferohen përmes buxhetit të UHZ sipas ligjit në fuqi.
3. Shuma dhe normat e pagesave të personelit dhe personave të angazhuar në projektet e QPB,

- duke përfshirë shpenzimet për shfrytëzimin e burimeve të QPB rregullohen sipas kontratave të veçanta në mes të palëve të përfshira në projekte sipas legjislacionit në fuqi.
4. UHZ do të përfitojë deri në 30% nga të gjitha të hyrat e gjeneruara të QPB, në mjete financiare apo materiale.

Hyrja në fuqi
Neni 14

Rregullorja e Qendrës për Përkrahjen e Bizneseve e Universitetit "Haxhi Zeka" hynë në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UHZ-së.

Kryesuesja e Këshillit Drejtues të Universitetit "Haxhi Zeka"

Prof.ass.dr. Majlinda Belegu

